

[REDACTED]

1099

175

LAW OFFICE OF VIRTYT IBRAHIMAGA

Attorney at law & Insolvency administrator

LAW OFFICE OF VIRTYT IBRAHIMAGA
Str. Fehmi Agani no.: 1/16 · 10010 Prishtina

II. Nr. 316/2020

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI PER ÇËSHTJE EKONOMIKE**

Federata Sindikale e PTK-së, Llagja Dardania p.n., Prishtine

- **Paditësja/Propozuesi** -

Dardafon.net LLC me seli ne rr. Dëshmori, fsh. Miradi e Epërme, Fushe Kosove, e përfaqësuar nga Avokat Virtyt Ibrahimaga, Rr. Anton Çetta 5a, 10000

- **E Paditura/Kundërshtarja e Propozimit** -

Konfrom aktvendimit të Gjykatës Themelore, Departamenti për Çyshtë Ekonomike te datës 28.07.2020 të pranuar nga e paditura me datë 29.07.2020, e Paditura parashtron këtë

PËRGJIGJE NË PADI DHE NË PROPOZIMIN PËR MASË SIGURIE

A) Çështjet paraprake për shqyrtim nga Gjykata

1) Kompetenca lëndore e Gjykatës

Paditësja në Padinë e saj nuk e ka sqaruar statusin e saj juridik dhe nuk e ka elaboruar kompetencën lëndore të Gjykatës në padinë e saj. Neni 16 i Ligjit për Gjykatat përcakton

Virtyt Ibrahimaga
Attorney at law & Insolvency administrator
Str. Fehmi Agani no.: 1/16 · 10010 Prishtina

VAT. No.: 330222894

Tel.: + 381/38 227 358
Fax: + 381/38 222 773
info@lawfirm-vi.com
www.lawfirm-vi.com

Raiffeisenbank Prishtine
Acc. no.: 1501 1100 0095 1351
IBAN: XK05 1501 1100 0095 1351
Swift Code: RBKOKPR

se Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike ka juridiksion lidhur me kontestet ne mes te Shoqërive Tregtare. Përderisa Paditësja nuk e sqaruar statusin e saj juridik, e Paditura e konteston jurdiskisionin e Gjykatës Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike lidhur me çështjen ne fjale.

2) Kompetenca e përgjithshme

Objekt i procedurës kontestimore sipas padisë së Paditëses është Marrëveshja për Mbështetje e datës 16.01.2009 (shtojca 31 e padisë). Neni 16.7 i kësaj Marrëveshje përcakton se rast kontesti lidhur me këtë marrëveshje kompetente do te jete Arbitrazhi sipas rregullave te se Odes Ekonomike Ndërkombëtare (ICC) dhe vendi i arbitrimit do te jete Londra. Prandaj Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk ka as kompetencë te përgjithshme lëndorë dhe as territoriale për të zgjedhur këtë kontest. Prandaj Gjykata konform nenit 391 të LPK-së duhet të hedhe Padinë e Paditëses si të palejueshme.

3) Legjitimiteti aktiv lëndor i palës

Paditësja nuk rezulton të jetë palë në Marrëveshje për Mbështetjeje të datës 16.01.2009, marrëveshje e cila sipas padisë është objekt i kontestit. Gjithashtu, nga padia nuk rrjedh se Paditësja e përfaqëson palën ne marrëveshje, gjegjësisht Telekomin e Kosovës Sh.a. Në mungesë te legjitimitet aktiv faktik të Paditëses për të përfaqësuar në këtë kontest, Gjykata duhet të hedhe padinë e Paditës si të palejueshme.

B) Baza juridike e padise

Padia nuk është e bazuar as në fakte dhe as në materie. E Paditura e konteston gjendjen faktike të pasqyruar nga Paditësja. Gjithashtu, e Paditura e konteston bazen juridike të kërkesëpadisë. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se e Paditura nuk ka legjitimitet aktiv ne këtë çështje ne këtë faze Paditësja nuk do të lëshohet ne detaje lidhur me gjendjen faktike dhe besueshmërinë juridike te padise, përderisa çështjet paraprake procedurale te lartshënuara nuk janë vendosur. Pas sqarimit të çështjeve paraprake dhe në rast se Gjykata vendose për lejueshmërinë e Padisë, e Paditura do të deklarohet një nga një lidhur me pretendimet e Paditëses.

C) Kërkesa për masën e sigurisë

Kërkesa e Propozuesës së Sigurimit është e palejueshme.

Propozuesja i masës së sigurisë nuk është pale kontraktuese marrëveshjen e cila është objekt i kontestit. Prandaj ajo nuk mund te parashtrroj kërkesë per mase sigurie. Kërkesa e saj është e palejueshme.

Nga aspekti përmbajtjesor kërkesa e Propozuesës së Sigurimit, përveç që nuk ka asnjë bazë juridike ajo është edhe absurde.

- Propozuesja e sigurimit ka kërkuar nga Gjykata që Kundërshtares së Sigurimit “t’ia ndaloj Vazhdimin e Marrëveshjes për Mbeshtetje të datës 16.01.2009, e cila ka përfunduar me datë 30.07.2019”. Se pari është jashtë secilës logjike juridike ndonjë skenar në të cilin Kundërshtarja e Sigurimit do të mund të vazhdonte vetiu një kontrate dypalëshe. Për me tepër Propozuesi i Sigurimit kërkon që Gjykata t’ia ndaloj Kundërshtares së Sigurimit vazhdimin e kontratës që sipas deklaramentit të Padiut ka skaduar me datë 30.07.2019. Kundërshtarja e Propozimit besoj që nuk ka nevojë të argumentoj faktin se ajo nuk mund t’i ekzekutoj këto veprime vetiu.
- Propozuesja e sigurimit ka kërkuar nga Gjykata që Kundërshtares së Sigurimit t’ia ndaloj negocimin e një kontrate tjetër për rrjet virtual të telefonisë mobile. Për çfarë arsye Propozuesja do të kishte një të drejtë të tillë ligjore, mundon secili shpjegim. Ndërsa Kundërshtarit të Propozimit i mundon imagjinata që të kuptoj se për çfarë arsye ajo nuk do të duhej të ketë të drejtë që të negocion një kontrate tjetër për rrjet virtual të telefonisë mobile.
- Propozuesja e sigurimit ka kërkuar nga Gjykata që Kundërshtares së Sigurimit t’ia ndaloj zbatimin e kontratave tjera. Për cilat kontrata Propozuesja e sigurimit e ka fjalën dhe në cilën normë ligjore ajo konsideron se e ka të drejtën të kërkojë një gjë të tillë, Propozuesja nuk e deklaron.
- Propozuesja e sigurimit ka kërkuar nga Gjykata që Kundërshtares së Sigurimit t’ia ndaloj disponimin me pasurinë e saj. Kjo kërkesë nuk ka asnjë bazë ligjore. Cilën kërkesë Propozuesi i sigurimit dëshiron të sigurojë përmes masës së sigurimit?
- Se fundi Propozuesja e sigurimit ka kërkuar nga Gjykata që Kundërshtares së Sigurimit t’ia ndalojë të kërkojë ose pranojë përmbushjen e obligimeve sipas vendimit të Arbitrazhit. Se pari Gjykata nuk mund t’ia ndalojë asnjë palë që të kërkojë diçka. Se këndejmi, Vendimi i Final Arbitrazhit 20990/MHM i datës 09.12.2016 është vendim i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm. Ky vendim është njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm përmes Aktrvendimit IV.Vr.nr. 388/13 të Gjykatës Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike të datës 11.02.2018 (bashkangjitur aktvendimi i Gjykatës)

Neni 97.1 i LPK i përcakton kushtet në të cilat mund të mjerët një masë e sigurisë.

Kusht i parë është që propozuesi të bejë të besueshme që ka kërkesë. Propozuesja përveç që nuk ka kërkesë të bazuar, ajo nuk ka legjitimetet të paraqes një kërkesë se saj. Ajo nuk është palë kontraktuese dhe nuk e përfaqëson asnjë palë në kontraktuese të objektit të kontestit.

Me tuje ajo do te duhej te bënte te besueshëm qe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës. Propozuesja e sigurimit ka ngritur padi për anulimin e nja kontratë e cila sipas deklaramit te saj ka skaduar me date 30.07.2019, gjë qe ne vehte parqet absurditet. Për me tepër, masat e kërkuara përveç qe janë kërkuar nga pala e paautorizuar (nëse mund te jete fare pale ne procedure) ato nuk kane te bëjnë me kërkesën nga padia. Ne secilin rast Kundërshtari i Sigurimit nuk mund të rrezikonte kërkesëpadinë e Paditesës.

D) Shpenzimet e përfaqësimit


E Paditura përfaqësohet në këtë procedure përmes avokatit. Shpenzimet për përfaqësim për Shuma e kompozimit momentin konstituojnë ne përpilimin e përgjigjes ne padi dhe kërkesës pre mase te përkohshme. Avokatit të Paditures lidhur me kete parashtrere i takon shpërblimi ne shume prej € 406,25sipas Nr. tarifor 6. të Rregullorës për Tarifat e Avokatëve.

Duke u bazuar në të lartcekurat, i propozojmë Gjykates si vijon:

AKTVENDIM

- 1) Hedhet si palejuar kërkesa e Paditëses Federata Sindikale e PTK-së, Lagjja Dardania p.n., Prishtine pre nxjerrjen e masës se sigurisë.
- 2) Hedhet si e palejuar padia e Paditëses Federata Sindikale e PTK-së, Lagjja Dardania p.n., Prishtine.
- 3) Obligohet Paditësja Federata Sindikale e PTK-së, Llagja Dardania p.n., që në emër të shpenzimeve të përfaqësimit t'ia paguaj të Paditurës shumen prej 406,25 EUR.


Prishtinë, datë 04.08.2020



Virtyt Ibrahimaga

Avokat

Avokat · Attorney at law
Virtyt Ibrahimaga LLM.
Anton Cetta 5a, 10000 Prishtinë
Tel. 038 227 358; Fax: 038 222 773
Email: info@lawfirm-vi.com

05.08.20
2 prej dare
me


AUTORIZIMI

A U T O R I Z I M

Autorizoj z. Virtyt Ibrahimaga Avokat në Prishtinë, që të përfaqësojë kompaninë tone **Dardafon.net LLC me NRB 70540878** në lenden, përkatësisht Propozim për Njohje dhe Permbarueshmeri të Vendimit të Huaj të Arbitrazhit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

E autorizoj veçanërisht që të na përfaqësojë në të gjitha fazat e procedurës paragjyqësore, ndërmjetësuese, të arbitrazhit dhe procedurës juridike para organeve gjyqësore, shtetërore, doganave dhe të pavarura, dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ndërmarrjes sonë. I autorizuari mund të ndërmarr të gjitha veprimet juridike dhe t'i përdorë të gjitha mjetet juridike, e veçanërisht të ushtrojë padi dhe parashtresa të tjera, të lidhin ujdi, të ushtrojë ankesa dhe mjete të tjera të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike si dhe të ndërmarrin të gjitha punët juridike për të cilat gjënë se janë në interesin tonë.

Në rast nevojë këtë autorizim Avokatet e lartcekur mund ta bartin pjesërisht apo në tërësi në personin tjetër sipas zgjedhjes së tij.

Prishtinë, më 16.07.2018

Milot Gjokolli

Drejtor

V.V

AKTVENDIMI IV.C.NR.398/18

(Për njohjen e vendimit të Arbitrazhit)

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Murat Paçarada në çështjen juridike të propozuesit Dardafon.net LLC, me seli në fshatin "Miradi" Komuna e Fushë Kosovës, rruga "Dëshmori", të cilën e përfaqëson Virtyt Ibrahimaga, avokat nga Prishtina, kundër kundërshtarit të propozimit Telekom i Kosovës. me seli në Prishtinë, "Dardania" p.n, të cilën e përfaqëson Gazmend Nushi, avokat nga Prishtina, për shkak të njohjes së vendimit të arbitrazhit të huaj, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 31.01.2019, me dt.11.02.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **NJIHET DHE SHPALLËT I EKZEKUTUESHËM VENDIMI I TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT**, pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC) Rasti OEN-it, me nr.20990/MHM, Vendi i Arbitrazhit: Londër, Angli, Vendimi përfundimtar i datës 09.dhjetor 2016, në çështjen juridike në DARDAFON.NET L.L.C, me seli në fsh "Miradi" Komuna e Fushë Kosovës,(Republika e Kosovës), si paditës dhe Telekom i Kosovës sh.a (ish PTK sh.a) me seli në Prishtinë, Republika e Kosovës, si i paditur, në tërësi, si në Diapozitivin e Vendimit të lartcekur.
- II. **OBLIGOHET**, Kundërshtari i Propozimit, që Propozuesit t'ia paguaj shpenzimet e procedues për Njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të Tribunalit të arbitrazhit në shumën prej 2.150.00€

A r s y e t i m i

Propozuesi Dardafon.net.L.L.C, me seli në fsh "Miradi" Komuna e Fushë Kosovës, me datën 16. Korrik 2018, ka paraqitur propozim për njohjen dhe shpalljen të ekzekutueshëm të vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC), Rasti OEN-it, me nr.20990/MHM, të datës 09 dhjetor 2016, Vendi i Arbitrazhit Londër, Angli, në mes të Propozuesit dhe Kundërshtarit të propozimit.

Në propozim ndër të tjera është theksuar se vendimi i lartcekur i arbitrazhit është mbështetur në kontratën për mbështetje të dt.16 janar 2009. Pas lindjes së kontestit lidhur me interpretimin e kontratës, propozuesi ka iniciuar në vitin 2015, procedurat e Arbitrazhit kundër Kundërshtarit të propozimit. Me dt.21.Nëntor 2016, Tribunali i Arbitrazhit, e ka nxjerr vendimin preliminar sa i përket Kompetencës së Arbitrazhit, e cila ishte kontestuar nga kundërshtari i propozimit.

Me dt.9 dhjetor Tribunali i Arbitrazhit, nxori Vendimin Përfundimtar, i cili edhe është objekt i kërkesës për njohje dhe ekzekutim. Në kërkesë theksohet se Tribunali i Arbitrazhit i Odës Ndërkombëtare Ekonomike (ICC) në përbërje nga 3(tre) Arbitra ka nxjerrë vendimin final të dt.09.dhjetor 2017, në kontestin në mes Propozuesit dhe Kundërshtarit të Propozimit, e që ky Vendim paraqet vendim arbitrazhi në kuptim të nenit 39.1 të Ligjit për Arbitrazhin.

Në kërkesë, më pastaj theksohet se procedura e Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare, ka arritur si rrjedhojë e marrëdhënieve kontraktuese në mes Propozuesit dhe Kundërshtarit të propozimit, të cilët marrëdhëniet e tyre i kanë definuar me Marrëveshjen për mbështetje të dt.16.janar 2009,gjegjësisht në nenin 16.7 të kësaj kontrate palët janë dakorduar se:

”Çdo kontest që del nga palët lidhur me këtë Marrëveshje do të nënshtrohet procedurave të brendshme për zgjedhje të kontestit. Ne qoftë se kontesti nuk do të mund të zgjidhet nëpërmjet kësaj procedure, atëherë secila palë ka të drejt të inicioj Arbitrazhin në Londër, Angli, në pajtim me rregullat e Odës Ekonomike Ndërkombëtare(ICC)”

Me Vendimin e Pjesshëm të juridiksionit, dhe shpenzimet e Tribunalit të Arbitrazhit, pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare me nr. të rastit 20990/MHM, të dt.09.dhjetor 2016,është urdhëruar që;

- 1.Kundershtari i Propozimit menjëherë;
 - a)T’i alokoj Propozuesit numrat mobil sipas kërkesës së tij, konform nenit 2.6.1 të Marrëveshjes për Mbështetje,
 - b)T’i ofroj Propozuesit shërbimet 3G dhe 4 g,sipas neit 2.4.1 të Marveshjes për Mbeshtetje,
 - 2.Kundershtari i propozimit t’i liferoj shërbimet SIM Kartelet sipas kërkesës së tij,
 - 3.Kundershtari i propozimit t’i paguaj dëmshpërblimin material Propozuesit si në vijim;
 - a)Paguaj Propozuesit shumën prej 8,785.000.00€ në emër të shpërblimit të demit së bashku me kamatën në lartësi prej 8%,nga data 14 prill 2015,
 - b)Paguaj Propozuesit shumën prej 17,315,000,00€,në emër të fitimit të humbur së bashku me kamatën prej 8%,nga data 14 prill 2015,
 - 4.Paguaj dëmin kontraktual në shumën prej 5.000.00€,në ditë, për secilën ditë nga data e vendimit të arbitrazhit(9 dhjetor 2016),në rast të vonesës me ;
 - ofrimin e numrave mobil nga pika 1.a,si më lartë,
 - ofrimin e shërbimeve 3/4G nga pika 1.b,më lartë,
- Deri në liferimin e shërbimeve, por maksimalisht shumën prej 17.315.000.00€,së bashku me kamatën në lartësi prej 8%,nga data 14 prill 2015,

5.Ti paguaj Propozuesit shpenzimet e procedurës së arbitrazhit në shumën prej 972.121.22€ dhe 534.000.00USD,
Se fundi Propozuesi thekson se i ka plotësuar të gjitha kushte e parapara me nenin 39 të Ligjit për Arbitrazhin, andaj i propozon gjykatës që të merr aktvendim me të cilin do ta aprovoj Propozimin e Propozuesit në tersi si në propozim.

Kundershtari i Propozimit e ka kundërshtuar Propozimin për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit të huaj me nr.2009/MHM, dt.21 nëntor 2016,të cilat kundërshtime të njëjta i ka përsëritur edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.31.01.2019.

Propozuesi i Propozimit për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimit Përfundimtar të Përfundimtar të Arbitrazhit të huaj me nr.2009/MHM,dt.21 nëntor 2016, me shkrim ju ka përgjigjur kundërshtimeve të Kundërshtarit të Propozimit të cilat përgjigje të njëjta i ka përsëritur edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Në këtë seancë gjyqësore të dt.31.01.2019,përfaqësuesi i Propozuesit deklaroi se mbetet pas kërkesës për Njohjen e Vendimit të Huaj të Arbitrazhit.

Përfaqësuesi i Kundërshtarit të Propozimit deklaroi, lidhur me propozimin për ndërprerjen e kësaj seance për shkak të ekzistimit të Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nga ana e Prokurorit të Shtetit, të njëjtën e tërheqim, pasi që ndërkohe kamë kuptuar se Gjykata Supreme ka marrë aktvendimin A.m.l. nr. 1/2017,me të cilën e ka hedhur Kërkesën e Prokurorisë, si të pa lejueshme në këtë fazë me pretekst se kjo kërkesë mund të bëhet pasi të përfundon procedura e njohjes dhe ekzekutimit.

Në vazhdim mbetem pranë propozimit për ndërprerje të procedurës në këtë çështje për shkak të ekzistimit të procesit aktiv penal, e që në këtë procese Gjykata penale e shkallës së parë ka marrë aktvendim PKR. Nr. 202/18 me të cilën e ka hudhër Aktakuzën e Prokurorisë, ndërkohë që lënda gjendet në Gjykatën e Apelit.

I propozon gjykatës që çështjen ekzistimit të procesit penal ta trajtoj si çështje paraprake, komfor neni 13 lidhur me nenin 8 të LPK-së, me aktvendim ta ndërprejë procedurën deri në përfundimin e procedurës aktive penale.

Përfaqësuesi i propozuesit lidhur me këtë propozim nder të tjerash deklaroi; Se nuk e kundërshton propozimin e kundërshtarit të propozimit që gjykata ta trajtoj si çështje paraprake kërkesën për ndërprerjen e seancës për shkak të ekzistimit të procedurës penale. Mirëpo,procedura penale nuk ka të bëjë fare me Vendimin e Arbitrazhit ose me Propozuesin e Kërkesës, i propozon gjykatës që kërkesën për ndërprerje të seancës ta refuzoj, dhe të vazhdojmë me procedurën e rregullt që ka për objekt një çështje e cila nuk preket nga asnjë procedurë penale, dhe se procedura e tillë nuk mundet me pas asnjë ndikim në këtë procedurë të parapara me Ligjin për Arbitrazhin.

Gjykata e refuzon, Propozimi i kundërshtarit të Propozuesit për Ndërprerjen e procedurës, për shkakun se është duke u zhvilluar një procedurë penale ndaj drejtorëve të PTK-së.

Në vazhdim Kundërshtari i Propozuesit thekson së mbetet në tërësi pranë kundërshtimeve , fillimisht pranë kundërshtimit mbi bazën e nenit 39.4 të Ligjit për arbitrazhin dhe nenit 6 të Konventës së Nju Jorkut, sepse Klauzola e Arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas drejtës së caktuar nga palët. Nëse lexohet me vëmendje Vendimi Final, Njohja e të cilës kërkohet kuptohet se ky vendim është vendim i Odës Ekonomike Ndërkombëtare me seli në Paris- Francë.

Ky vendim në raport me Klauzolën e Arbitrazhit është plotësisht jo kompetent, sepse në pikën 16.7 të Marrëveshjes Komerciale në mesë palëve e cila në fakte është klauzola e arbitrazhit shkruan ; “secila palë mund ta nis Arbitrimin në Londër-Angli nën Rregulloret e OEN”, e që në praktikën dhe teorinë e forumeve ma të njohura të arbitrazhit nuk ka asnjë dilemë se në një klauzolë të arbitrazhit duhet qartë të identifikohet vullneti i palëve nënshkruese, në kuptimin e forumit të arbitrazhit, vendi, gjuha, numri i arbitrave etj. Rëndësi të posaçme ka pajtueshmëria e vullnetit të nënshkruesve lidhur me forumin e arbitrazhit, apo institucionit të arbitrazhit, i cili do ti zgjidhë mos marrëveshjet e tyre.

Në rastin konkret, nuk ka asnjë dilemë se nga formulimi i klauzolës së arbitrazhit, pajtueshmëria e palëve, lidhur me forumin është një forum i pa identifikuar, por i cili selinë e ka në Londër e jo në Francë .Shton më pastaj se në praktikën e Arbitrazhit Ndërkombëtar ekziston parimi i njohjes “ personit të arsyeshëm” sipas të cilit kriter interpretohen të metat e një klauzole siç është kjo në rastin konkret . Ai person është një person i imagjinuar me aftësi intelektuale dhe profesionale mesatare dhe sipas të cilit do duhet të epët përgjigja në këtë pikë të kundërshtimit .

Nisur nga ky kriter dhe nga formulimet e bëra është plotësisht e besueshme se nuk do gjendej asnjë person i arsyeshëm i cili formulimin, se secila palë mund ta nis arbitrimin në Londër-Angli do

të interpretonte se mund ta nis arbitrimin në Francë –Paris, dhe aq ma tepër seancat ti mbajnë në Austri-Vjen siç është në rastin konkret .

Kjo e metë e evidente e vullnetit lidhur me formimin e arbitrazhit objektivisht e shndërron këtë klauzolë në “ klauzolën patologjike” , e cila rëndon ju shërben gjykatave nacionale për ta anuluar klauzolën e tillë, siç është rasti edhe me vendimin e Gjykatës së Gjermanisë, e cila është dorëzuar si provë e cila në një rast shumë të ngjashëm për të mos thënë identik, është anuluar klauzola e arbitrazhit.

Thekson në vazhdim se ky Arbitrazh, ka vendosur për çështje jashtë kompetencës së saj, dhe për çështje të cilat hynë në kompetencave ekskluzive të gjykatave vendore. Ashtu siç është cekur në kundërshtim pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë qysh në vitin 2013, është nisur procedura e cila në mënyrë të drejtë për drejtë ndërlihet me alokimin e numrave mobil e cila është pjesë e petitumit të vendimit final. Këtë procedurë administrative e ka nisur vetë propozuesi me shkresën të cilën me dt. 24.01.2013 ia ka dorëzuar Rregullatorit ARKEP.

Në këtë situatë kur një pjesë e kërkesëpadsisë është iniciuar para gjykatave vendore nuk mund të nisët procedura e arbitrazhit, sepse në këtë iniciim vetë propozuesi ka shprehur vullnetin që kjo çështje të zgjidhet para gjykatave vendore.

Sa i përket çështjeve të cilave vendimi final i arbitrazhit ka ndërhyrë në kompetencë të gjykatave vendore, që bëhet fjalë konkretisht në ofrimin e shërbimeve 3G dhe 4G, e jo në sim kartela siç pretendon përfaqësues i propozuesit, e që ky shërbim ofrohet nëpërmjet 345 pikave në tërë territorin e Kosovës, në formën e antenave të cilat të gjitha pa përjashtim janë të vendosura në paluajtshme rinë e kundërshtarit të propozimit qofshin ato në pronësi e tij apo të marra me qira .

Të gjitha këto pika komandohen nga një qendre zyrtare e cila gjendet në selinë qendrore të Kundërshtarit të Propozimit nëpërmes instalimeve tejet specifike të cilat janë pjesë përbërëse të asaj godine.

Neni 10 i Ligjit të pronësisë, shpjegon se çka nën kuptohet në termin paluajtshme ri ku thuhet se aty përpos tjerash përfshihen edhe instalimet dhe pajisjet, e që rrjedhimisht e në mbështetje të nenit 41.1 të LPK-së të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me paluajtshme ri janë kompetencë ekskluzivë territoriale të gjykatave vendore. Andaj, një ndërhyrje aq brutale e Arbitrazhit në Kompetencën Ekskluzive të gjykatave cenon nenin 2.2, si dhe 46.2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës, e cila përcakton se çështja e pronës rregullohet me ligj.

Shton më pastaj se në pikën 1 dhe 2 të diapozitivit të vendimit final, kundërshtari është obliguar ta përmbush detyrimin kontraktuese, kurse në piklën 3 obligohet që ta paguan edhe dënimin kontraktues me legjislacionin e Kosovës, e që në këtë rast nuk mund të kërkohet edhe përmbushja e detyrimit edhe dënimi kontraktues. Thekson në vazhdim se çfarë kuptimi ka dënimi kontraktues nëse përmbushet detyrimi dhe anasjelltas, për ma tepër përpos përmbushjes së detyrimit pagesës së demit, dhe dënimin kontraktues është përllogaritur edhe fitimi i humbur mbi 17.000.000,00 €, atëherë si mund të ketë fitim të humbur në dënim, besoj se këtë nuk e njeh asnjë legjislacion modern botëror. Po ashtu edhe formulimi i pikës 2 ku thuhet se kundërshtari duhet ta jep sasinë e caktuar të sim kartelave, propozuesit qysh i kërkon ai kohë pas kohe, përpos se është i pa qartë është plotësisht e i pa përshtatshëm për çfarëdo lloj përmbarim.

Dhe së fundi nëse ky Tribunal e ka detyruar Kundërshtarin ta përmbush detyrimin kontraktuese, ta paguan dënimin kontraktues, ta paguan kamatën, dhe mbi të gjitha këtu të paguan edhe fitim të humbur, si dhe dënimi 5.000,00 € në ditë, andaj aprovimi eventual i Propozimit do ishte një president i jashtë zakonshëm negativ sepse do ta legalizonte pa asnjë dilem Institutin e pasurimeve të pabazë në anën e propozuesit.

Me dt. 24.05.2017 palët kanë lidhur marrëveshje për zbatimin e këtij vendimi final e ku sipas kësaj marrëveshje deri më tani kundërshtari i propozimit i ka paguar shumën prej 4,192,292.01 €, ndërsa këtë marrëveshje e ka shkëputur vetë propozuesi me parashtrësën e tij të dt. 27.04.2018 në mënyrë të një anshme.

Në fund gjykatës i propozon marrjen e njërit prej vendimeve alternative:

Ta refuzon në tërësi Propozimin për Njohjen dhe Ekzekutimin, ose Pjesërisht ta Njehë Vendimin dhe Ekzekutimin, duke i zbritur nga petitumi i Vendimit final vlerat milionëshe të cilat janë përlllogaritur në kundërshtim të plotë me legjislacionin, normat imperative, dhe rrjedhimisht edhe me Rendit publik të Republikës së Kosovës.

I kërkon shpenzimet e procedurës konform tarifës 6 dhe 7 të Odës së Avokatëve me tarifën e që janë për përfaqësim 845,00€ për parashtrësë 650,00 € respektivisht në vlerëson totale prej 1495,00€.

Përfaqësuesi i propozuesit thekson se është një kalkulimi ose mos kalkulimi i pagesë së PTK-së me kërkesën tonë për Njohje të vendimit të arbitrazhit. Unë nuk e kontestoj fare që pretendimet e kundërshtarit të propozimit se PTK-ja i ka paguar shumën prej 4,192,292.01€, mirëpo ne duhet ta kemi të qartë se në këtë procedurë nuk trajtohen vlerat e paguara pas Vendimit të Arbitrazhit, e ma së paku trajtohen çështjet që nuk janë kontestuese. Ky propozim ka të bëjë me njohjen e një vendimi të arbitrazhit, e që edhe unë atë vendim nuk mund ta ndryshoj, nga shkaku se objekt i kësaj procedurë është Njohja e atij vendimi.

Në procedurën e përmbarrimit natyrisht që do të zbriten vlerat e paguara në propozim edhe nëse sikur mos të zbriteshin ato në procedurë të përmbarrimit kundërshtarit i propozimit mundet me ushtrua prapsim, pra objekt i kësaj procedura nuk janë vlerat përfundimtare të cilin PTK-ja, duhet me ja pagua propozuesit, po është Njohja e një vendimi të huaj.

Në procedurën e përmbarrimit trajtohet çështja e vlerave të paguara, që sigurisht dëshmojnë edhe me dëshmi, edhe nuk kanë ku me humbë, e në çoftë se ne në atë procedurë kemi ndonjë paqartësi, atëherë mund të iniciojnë procedurat përmbarrimore, apo procedurën kontestimore. Thekson se kjo çështje nuk mund të trajtohet në këtë procedurë e cila nuk është kontestimore, po si mbas vendimit të Gjykatës Supreme është jashtë kontestimore.

Sa i përket kontratës që është lidhur në mesë të palëve për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit kjo është një kontratë e cila është shkëputur nga ana e parashtrësit të propozimit, dhe nëse ka ndonjë pretendim pala tjetër lidhur me këtë kontratë mund me inicua procedurë kontestimore. Nuk qëndron pretendimi se propozuesi nuk ka qenë i interesuar për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, kundërshtarit i propozimit 6 muaj ditë ka refuzuar me zbatua këtë vendim të arbitrazhit, janë akumuluar interesa me miliona, dhe mbas 6 muajve propozuesi është pajtuar me hy në marrëdhënie kontraktuale, e që të gjitha ato interesa me u shlye.

Përkundër kësaj PTK-ja, prapë nuk ju ka përmbajtur kësaj Kontrate për Ekzekutim, andaj propozuesi është detyruar me e shkëput marrëveshjen për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit. Sa i përket pretendimeve tjera jemi deklaruar me shkrim për secilin veç e veç për disa nuanca shtesë që janë paraqitur këtu, pa u leshur në komentet e kundërshtarit të propozimit lidhur me integritetin e Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe integritetin tim. Procedura administrative të cilën kundërshtarit i propozimit e përmend ka të bëjë me liferimin e numrave, dhe sim kartelë.

ARKEP ka vendosur që ankesën e propozuesit në procedurë administrative me ja pranuar si të bazuar ligjërisht. Kundër atij vendimi është ankuar PTK-ja, dhe në instancë të parë të Gjykatës Administrative, e ka humbur kontestin, në instancë të dytë nuk e di nga fakti se ajo procedurë nuk ka qenë ma relevante, sepse njëkohësisht është iniciuar Procedura e Arbitrazhit, e cila gjitha ashtu e ka vërtetuar faktin se si mbas kontratës, liferimi me sim kartela, dhe me numra ka qenë detyrim kontraktues edhe ligjor i PTK-së, prandaj edhe nuk e është e kuptueshme se çfarë ndikimi mundet me pas procedura administrative me këtë procedurë.

Lidhur me kompetencën e Gjykatës së Arbitrazhit, pretendimet e kundërshtarit të propozimit janë tërësisht të gabuar si nga ana praktike ashtu edhe nga ana juridike. Procedura e arbitrazhit nuk është zhvilluar në Paris, siç thekson kundërshtarit i propozimit, mjafton të lexohet faqja e fundit të

vendimit të arbitrazhit, shihet se vendi i arbitrimin është në Londër Angli. Pastaj ky vendim nuk është lëshuar prej Odes Ndërkombëtare Komerciale siç pretendohet, por ky vendim është lëshuar prej Tribunalit të Arbitrazhit ad hok, i cili i ka aplikuar rregullat e Arbitrazhit Internacional të Odës Tregtare ndërkombëtare ACC.

Në vazhdim të fjalës së vet Propozuesi thekson se Kompetencën për zgjidhjen këtij kontesti kundërshtari i propozimit e ka kontestuar edhe në procedurë të arbitrazhit, po ja që Arbitrit, kanë vendosur që kundërshtimi i kompetencës nuk ka bazë kontraktuese dhe ligjore. Kundër këtij vendimi Kundërshtari i propozimit ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Lartë të Londrës, e cila është kompetente në këtë rast për shqyrtimin lidhur me vendimin e pjesshëm për kompetencë të Tribunalit të arbitrazhit. Edhe Gjykata e Lartë e Londrës, ka vendosur që Tribunali i Arbitrazhit ka pasur kompetencë edhe territoriale edhe lëndore me nxjerrë vendimin e arbitrazhit.

Tani, Kundërshtari i Propozimit, klauzolën e arbitrazhit” e kontestoni edhe në këtë procedurë pranë kësaj gjykate, e cila në fakt nuk ka kompetencë për me shqyrtuar klauzolën e arbitrazhit, kur palët janë pajtuar që ti nënshtrohen juridiksionit ndërkombëtar të arbitrazhit.

Sido qoftë të gjitha ato pretendime për jo “Validitetin e klauzolës së arbitrazhit” janë trajtuar nga gjykata kompetente, edhe përfundimisht nga Gjykata e Lartë e Londrës, ndërsa janë plotësisht të pabazuara pretendimi i kundërshtarit të propozimit se çështja në fjalë ka të bëjë me pronë e paluajtshme.

Kontrata për mbështetje në mesë parashtruesit të propozimit dhe kundërshtarit të propozimit ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve edhe pagesën për ato shërbime, nuk ka të bëjë asgjë me pronën e paluajtshme ose kontratat e qirasë, që mundet me i pasur PTK-ja me palët tjera.

Sa i përket kalkulimit të dëmit të bërë nga Gjykata e Arbitrazhit, ky kalkulim ka qenë pjesë e shqyrtimit gjyqësor ku janë përgatitur dy ekspertiza të firmave ndërkombëtare të Auditit. Demi kontraktues ka qenë i përcaktuar në kontratë, por ky dem i kontraktuar nuk e përjashton mundësinë që pala të kërkoj dëm tjera që ju kanë shkaktuar në baza ligjore. Se si ka ardhur deri ke ky kalkulim detajet janë të precizuara në Vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit. Të gjitha pretendimet tjera në mënyrë të detajua i kam dhen në përgjigjen e kundërshtimit e kundërshtarit të propozuesit, të dorëzuara gjykatës me dt. 29.10.2018.

I propozon, gjykatës që sipas kërkesës së parashtruesit të propozimit ta njohë vendimin e arbitrazhit të huaj, konform Ligjit për Arbitrazhin të Kosovës, si dhe ta Detyroj Kundërshtarin e propozimit që ti bartë shpenzimet e procedurës duke përfshirë, shpenzimet për dy parashtrës nga 650,00=1.300.00€, si dhe për përfaqësim në një seancë 850,00 €, gjithsejtë shuma 2150,00 €.

Pas shqyrtimit të propozimit për njohjen dhe shpalljen të ekzekutueshëm të vendimit të arbitrazhit të huaj, deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, kundërshtimit me shkrim të Kundërshtarit të Propozimit Telekomit i Kosovës, dhe deklaratave nga seanca e shqyrtimit gjyqësor, gjykata erdhi në përfundimin se janë plotësuar kushtet ligjore për Njohjen dhe Shpalljen të Ekzekutueshëm të Vendimit të lartcekur, të përcaktuara me nenin 39 të Ligjit për Arbitrazhin.

Gjykata konstaton se Propozimit të Propozuesit i janë bashkëngjitur të gjitha provat e nevojshme të përcaktuara me dispozitat ligjore të lartcekura.

Gjithashtu, gjykata vlerësoi se Vendimi i Arbitrazhit të cilit i referohet Propozimi për Njohje dhe Shpallje të Ekzekutueshëm, nuk është në kundërshtim me nenin 39.5 të Ligjit për Arbitrazhin, gjegjësisht nuk ka të bëjë me kontestin që nuk mund të zgjidhet përmes arbitrazhit dhe nuk është në kundërshtim me Rendin publik të Republikës së Kosovës.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e kundërshtarit të propozimit të parashtruara me shkrim dhe në seancën gjyqësore mirëpo gjykata i refuzoi pretendimet e tij nga shkak se procedura gjyqësore kishte të bënte me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.


Nga ana tjetër, nga vendimi i arbitrazhit e konkretisht nga arsyetimi i atij vendimi, është vënë në pah se Kundërshtari i propozimit si palë e paditur në atë procedurë, ka qenë pjesëmarrëse aktive në procedurë, ku ka parashtruar kërkesa dhe pretendime të ndryshme dhe që të gjitha janë trajtuar nga Tribunali i Arbitrazhit, ndërsa përfundimisht vlerësimet përkitazi me pretendimet e tij janë arsyetuar në Vendimin Final e Tribunalit të Arbitrazhit.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata erdhi në përfundimin se janë plotësuar kushtet ligjore për Njohjen dhe Shpalljen të ekzekutueshëm të vendimit të lartcekur të arbitrazhit dhe rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykate e bazon në dispozita e nenit 452 par.1 të LPK-së, dhe konform Tarifës së Odes se Avokateve te Kosovës. Propozuesi e ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të procedurës, dhe ka bërë specifikim e tyre si në vijim: në emër te përpilimit të dy parashtrësave nga 650.00€=1300.00€,për përfaqësim ne një seancë gjyqësore 850.00€,gjithsejt shumen prej 2150.00€.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
IV.C.nr.388/18 i dt.11.02.2019

Gjyqtari,
Murat Paçarada



UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.